



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Tiranë, 17.05.2024

Njoftim

99-vjet institucion, KLSH organizon aktivitetin “Java e hapur” nga data 20-24 maj 2024

Në kuadër të 99-vjetorit të themelimit si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar në Republikën e Shqipërisë, si dhe mbështetur në standardin ndërkombëtar të Institucioneve Supreme të Auditimit, ISSAI 12, “*Vlerat dhe dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit - të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve*”, Kontrolli i Lartë i Shtetit do të organizojë nga data 20 deri më 24 maj 2024, aktivitetin “Java e hapur”.

Me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për rolin e KLSH-së, përgjatë këtyre ditëve, Kontrolli i Lartë i Shtetit do të jetë i hapur për të pritur qytetarë, studentë, profesionistë të fushave të ndryshme, përfaqësues të shoqërisë civile.

Aktiviteti “Java e hapur” do të zhvillohet në mjediset e KLSH-së. Orari i vizitave për publikun do të jetë çdo ditë nga ora 10:00-14:00. Specialistë të institucionit si dhe auditues do të angazhohen për të pritur në takime çdo pjesëmarrës.